

Në bazë të Ligjit për shoqata të qytetarëve dhe fondacione (Gazeta Zyrtare e RM numër 52 prej 16.04.2010), Kuvendi i Shoqatës së qytetarëve **“H.E.R.A.” Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim**, Shkup, në mbledhjen e mbajtur më 03.06.2010 e verifikoi tekstin e pastruar të

STATUTIT

të Shoqatës së qytetarëve **“H.E.R.A.” Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim** – Shkup

Neni 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.1

Emri i *Shoqatës* do të jetë H.E.R.A. – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim (në tekstin e mëtejshëm vetëm *Shoqata*)

Emri në gjuhën angleze do të jetë HERA - Health Education and Research Association

Neni 1.2

Selia e *Shoqatës* do të jetë në adresën:

Rruga Debarca nr.56 kati 2 banesa 4

1000 Shkup

Maqedoni

Shoqata organizohet dhe do të verojë në gjithë territorin e Maqedonisë.

Neni 1.3

Shoqata është jopartiake dhe jofitimprurëse, nuk udhëhiqet nga interesa komerciale, gjegjësisht nuk është themeluar që të sjellë fitim.

Shoqata realizon aktivitete me të cilat realizon fitim, gjatë së cilës të ardhurat, prona e organizatës shfrytëzohen vetëm për realizimin e qëllimeve të saja të cekura të nenin 3 dhe të njëjtat nuk guxon të ndahen mes anëtarëve të *Shoqatës* pa marrë parasysh nëse personi është themelues, anëtar, i punësuar, drejtor, anëtar i bordit ekzekutiv ose organi tjetër.

Anëtarët e organizatës nuk guxojnë të fitojnë të mira materiale në bazë të pozitë së tyre, edhe pas shpërbërjes së *Shoqatës*.

Të ardhurat, mjetet materiale, as prona nuk guxon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, si huazim, dividendë, bonus ose profit t'i transferohen anëtarëve individual dhe të punësuarve.

Neni 2 QËLLIMET

H.E.R.A. synon në realizimin e të drejtave themelore të njeriut për gratë, meshkujt dhe të rinjtë, që të informohen drejt dhe të kenë qasje adekuate deri te shërbimet cilësore dhe të besueshme, që në mënyrë të lirë të mund ta realizojnë zgjedhjen e tyre lidhur me seksualitetin, parandalimin, kujdesin dhe trajtimin prej/për sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe HIV, duke përfshirë edhe mbrojtjen e plotë të drejtave të personave të cilët jetojnë me HIV/SIDA dhe të afërmit e tyre, kontracepsioni, abortimi i sigurt dhe legal, të drejtat seksuale dhe riprodhuese.

Qëllimet e veta *Shoqata* e realizon përmes bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe institucioneve të saja relevante, me shoqatat e qytetarëve, si dhe organizatat ndërkombëtare.

Neni 3 VEPRIMTARIA

Qëllimin Shoqata do ta realizojë në pajtim me veprimtarinë me interes publik të definuar në Ligjin për shoqata të qytetarëve dhe fondacioneve, Neni 74:

- 1.zhvillimi i demokracisë, shoqërisë civile dhe të drejtat e njeriut
- 2.mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve
- 3.mbrojtja e personave të margjinalizuar dhe përfshirja e tyre sociale
- 4.mbrojtja prej sëmundjeve seksualisht të transmetueshme
- 5.shëndetësia, avancimi i shëndetit dhe kujdesi mjekësor

Dhe atë përmes aktiviteteve më konkrete që vijojnë:

- hulumtim – grumbullimi i të dhënave për gjendjen aktuale me shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat e njeriut në territorin e Maqedonisë
- shërbime – sigurimi ose dërgimi deri te shërbimet shëndetësore dhe sociale për shëndetin seksual dhe riprodhues, HIV/SIDA, infektive të transmetueshme përmes seksit ose gjakut, shtatzëni e paplanifikuar dhe shmangia e abortit jo të sigurt.
- informimi – përpunimi, botimi dhe distribuimi i materialeve të shtypura dhe digjitale informative
- avokimi – avokim për përmirësimin e ligjeve ekzistuese ose miratimin e ligjeve të reja, akteve nënligjore, strategjive nacionale dhe lokale dhe programeve për shëndetin dhe të drejtat

seksuale dhe riprodhuese, avokim për ndryshimin e rregulloreve ligjore për përmirësimin e jetës së Personave të cilët jetojnë me HIV

- trajnim dhe ndërtimi i kapaciteteve – organizimi i trajnimeve për sektorin civil, pushtetin lokal dhe institucionet përgjegjëse për shëndetin seksual dhe riprodhues

Shërbimet e organizuara prej *Shoqatës* realizohen në bazë vullnetare dhe të besueshme, pa kurrfarë kushtëzimi me servis tjetër ose çfarëdo shpërblimi.

Neni 4 Përfaqësimi para ligjit

Përfaqësues juridik të *Shoqatës* janë *Kryetari* dhe *Drejtori ekzekutiv*.

Përfaqësues i *Shoqatës* mund të jetë personi fizikisht i aftë, i cili ka vendbanim ose qëndrim në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin.

Mënyra e emërimit ose zgjedhjes së *Përfaqësuesve* të *Shoqatës* është e rregulluar e këtë Statut.

Neni 5 ANËTARËSIA

Neni 5.1

Në *Shoqatë* mund të anëtarësohen qytetarë të Republikës së Maqedonisë dhe shtetas të huaj pa marrë parasysh të: seksit dhe gjinisë së tyre, moshës, përkatësisë etnike, racës së tyre, orientimi seksual, statusi i martesës, bindjet politike, religjioze dhe të tjera ose gjendja shëndetësore.

Parimet e lartpërmendura *Shoqata* do t'i aplikojë edhe gjatë punësimit të personelit, sigurimit të shërbimeve dhe gjegjësisht gjatë gjithë aspekteve të punës së tyre.

Personi i mitur që i ka mbushur 14 vjet anëtarësohet në *Shoqatë* me dhënien e deklaratës së nënshkruar për pëlqim të përfaqësuesit të tij ligjor për anëtarësim në organizatë në pajtim me ligjin.

Neni 5.2

Anëtar në *Shoqatë* mund të jetë secili, i cili, vullnetarisht do të inkuadrohet në *Shoqatë* me dorëzimin e deklaratës me shkrim – anëtarësim dhe deklaratë për konflikt të interesave deri te *Këshilli drejtues*. *Këshilli drejtues* e prezanton dhe e rekomandon anëtarin, i cili dëshiron të anëtarësohet në *Shoqatë* para *Kuvendit*, pas çka me shumicë votash vërtetohet anëtarësimi i tij.

Në *Shoqatë* është mundësuar edhe anëtarësimi kolektiv gjatë së cilës një shoqatë tjetër e qytetarëve ose institucion përfaqësohet nga një anëtar.

Shoqata e garanton fshehtësinë e të dhënave personale të anëtarëve në pajtim me rregullat për mbrojtje të dhënave personale dhe informatave të klasifikuara.

Neni 5.3

Për regjistrin e anëtarëve, i cili azhurnohet së paku një herë në dy vjet është përgjegjës Sekretari i organizatës.

Neni 5.4

Anëtarët e mbajnë statusin e tyre derisa nuk vdesin, nuk tërhiqen, pse derisa nuk suspendohen ose përjashtohen nga *Shoqata*.

Anëtari tërhiqet nga *Shoqata* me deklaratë me shkrim dhe dorëzimin e të gjitha materialeve, mjeteve për punë të cilat i ka shfrytëzuar/është ngarkuar gjatë aktiviteteve të tija.

Marrja e të drejtës për anëtarësim realizohet kur anëtari:

- nuk i përmbahet dispozitave të statusit të shoqatës dhe nuk vepron në interes të qëllimeve të caktuara me programin e tij
- krijon situata konflikti me anëtarët tjerë të organizatës, me çka e çrregullon punën aktuale të *Shoqatës*
- nuk merr pjesë aktive në shoqatë
- nëse nuk ka paguar anëtarësim në periudhën mes mbajtjes së dy Kuvendeve
- shkaqe tjera të cilat e rrezikojnë veprimin e *Shoqatës*

Këshilli drejtues sjell vendime për suspendim të anëtarësisë me shumë votash nga anëtarët e pranishëm. Anëtari i suspenduar përkohësisht e humb të drejtën e votës, nuk guxon të merr pjesë në aktivitetet, e as në çfarëdo mënyre ta përfaqësojë *Shoqatën*.

Heqja e suspendimit zbatohet me vendim të shumicës së *Kuvendit* pas diskutimit të hapur për shkaqet e tejkaluara për suspendim.

Këshilli drejtues propozon pezullimin e anëtarësisë.

Anëtari që është propozuar të përjashtohet para se të deklarohet *Kuvendi*, ka të drejtë t'i drejtohet organit.

Kuvendi e miraton vendimin për përjashtim të anëtarit me 51% të votave gjatë kuorimit të arritur nga anëtarët me të drejtë vote. Humbja e anëtarësisë do të thotë se personi nuk mund të zgjidhet përsëri për anëtar të *Shoqatës*.

Neni 5.5

Ekzistojnë tre kategori të anëtarësimin: të plotfuqishëm, shoqërues dhe korporatave.

- Anëtari i plotfuqishëm ka të drejtë për një votë gjatë kuvendit vjetor, ka të drejtë të zgjidhet në organet e *Shoqatës*, të merre pjesë në punën e *Shoqatës*. Anëtari i plotfuqishëm rregullisht paguan anëtarësim.

- Anëtari shoqërues mund të marre pjesë në Kuvendin vjetor, gjatë së cilës nuk ka të drejtë vote. Anëtarët shoqërues janë simpatizues të organizatës ose mysafirë. Anëtari shoqërues nuk paguan anëtarësim.

- Anëtarësimi korporativ fitohet me marrëveshje të veçantë mes *Shoqatës* dhe shoqatës tjetër, fondacionit, organizatës qeveritare ose joqeveritare. Anëtari korporativ parashtrohet informata periodike (gjashtëmujore) për ndryshimin e lokacionit të organizatës ose për ndryshim eventual të personit që e përfaqëson. Anëtari korporativ paguan anëtarësim dhe ka të drejtë vote.

- Në rast të formimit të degëve të veçanta, të gjithë anëtarët e degës janë anëtarë të plotfuqishëm edhe të *Shoqatës*, me të drejtat e njëjta.

- Sipas *Statusit të Shoqatës* nëse anëtari nuk është në gjendje të merr pjesë në *Kuvend*, është e mundësuar që ai/ajo t autorizojë ndonjë anëtar që ta përfaqësojë votën e tij. Gjatë kësaj i autorizuari mund të përfaqësojë vetëm një votë plotësuese. Autorizimi bëhet më së voni tre ditë para *Kuvendit* me dokument të verifikuar dhe të parashtuar deri te Sekretariati.

Neni 5.6

Anëtarët e ardhshëm pa dallim cilës kategori i takojnë, nuk kanë të drejtë të votës dhe nuk kanë të drejtë të zgjidhen në asnjë organ:

- të punësuar në Shoqatë

- anëtarët që nuk kanë paguar anëtarësim mes mbajtjes së dy Kuvendeve vjetore

Anëtarët e ardhshëm nuk do të mund të votojnë gjatë miratimit të vendimeve lidhur me sigurimin e materialeve ose shërbimeve:

- të gjithë anëtarët të cilët kanë konflikt të interesave gjatë vendimmarrjes.

Neni 5.7

Deklarata për konflikt të interesave parashtrohet gjatë plotësimit të fletë anëtarësimi drejt shoqatës.

Drejtori ekzekutiv, të punësuarit ose anëtarët e organeve ekzekutive japin deklaratë të hollësishme për konflikt të interesave, e cila përtërihet një herë në vjet.

Gjatë kësaj asnjë anëtar nuk guxon të përfitojë fitim të drejtpërdrejt ose indirekt financiar ose material përmes shfrytëzimit të pozitës së vet. Kjo ka të bëjë me çfarëdo shitje, distribuim, promovim të materialeve ose shërbime sevisi. Anëtari nuk guxon të pranojë dhurata ose të mira materiale nga ofruesi i shërbimeve ose furnizuesi i materialeve. Edhe më tepër nuk guxon të marre pjesë në vendimmarrje për punësim të bashkëshortit ose farefisit (gjysh, gjyshe, prindër, vëlla ose motër, djali ose vajza, nip ose mbesë ose farefis të bashkëshortit). Vendosja e farefisit

në pozita pune të nëpunësve dhe anëtarëve të organeve ligjdhënëse, bile edhe si konsulentë është e ndaluar.

Neni 5.8

Përveç kompensimit për shpenzime e krijuara nga zhvillimi i aktiviteteve të Shoqatës, anëtarët të cilët janë vullnetarë nuk guxojnë të pranojnë mjete tjera.

Anëtarët të cilët janë vullnetarë nuk guxojnë të pranojnë huazime nga fondet e *Shoqatës*.

Fitimi i realizuar duhet të shfrytëzohet në pajtim me nenin 3 të Ligjit për shoqatat e qytetarëve.

Neni 5.9

Vetëm anëtarët të cilët kanë paguar anëtarësim dhe kanë të drejtë vote mund të zgjidhen në *Këshillin drejtues* ose grupet tjera punuese.

Neni 6

Këshilli drejtues do ta caktojë shumën në të holla për anëtarësimin mujor që do ta hedhë në votim para *Kuvendit*.

Nëse Këshilli drejtues nuk propozon para Kuvendit shumë të re të anëtarësisë, në atë rast aplikohet vendimi paraprak.

Neni 7 KUVENDI

Neni 7.1

Kuvendi i Shoqatës është i përbërë prej anëtarëve të tij në pajtim me Nenin 5.4 dhe 5.4 Kuvendi thirret së paku një herë në vjet.

Neni 7.2

Me *Kuvendin* kryeson *Kryetari i Shoqatës*.

Në rast se *Kryetari* mos jetë në gjendje që të marrë pjesë për shkaqe të arsyeshme dhe mungesën e tij në mënyrë adekuate e ka paralajmëruar ose, nuk paraqitet në 30 minutat e para të mbledhjes, me *Kuvendin* do të kryesojë anëtari i *Këshillit drejtues* i cili është nëpunës-*Sekretar nderi*.

Me *Kuvendin* do të kryesojë cilido anëtar i Shoqatës i zgjedhur nga anëtarët tjerë me shumicë dy të tretave në këto raste:

- në rast të mungesës së *Kryetarit* ose nëpunësit të nderit
- me kërkesë të kryetarit

Neni 7.3

Programi i Kuvendit ka të bëjë me:

- raportet vjetore të punës së *Shoqatës*
- prezantimin e revizioneve vjetore të jashtme financiare
- raporte të *Këshillit drejtues*
- raport nga ana e *Drejtorit ekzekutiv* për punën e *Shoqatës*
- zgjedhja e nëpunësve të nderit dhe gjedhja e anëtarëve të *Këshillit drejtues me të dejtë vote*
- pyetje lidhur me të gjitha sferat e përcaktuara në Përgjegjësitë e *Kuvendit* në Nenin 8

Neni 7.4

Para çdo Kuvendi, *Drejtori ekzekutiv* do të dorëzojë listën e anëtarëve dhe të drejtën e tyre për votë deri te Sekretari i Shoqatës.

Nëpunësi-*Sekretari* i nderit i emëruar enkas, anëtar i *Këshillit drejtues*, do të kujdeset gjatë *Kuvendit* për listën e anëtarëve të pranishëm dhe për realizimin e të drejtës për votë.

Lista e azhurnuar e anëtarëve dhe të drejtën e tyre për votë do të mbyllet deri në fund të ditës së punës para se të dërgohet ftesa për *Kuvend*.

Në ftesën për *Kuvend* duhet të ceket vendi, koha dhe data e mbajtjes së *Kuvendit* si dhe Programi i tij.

Të gjithë anëtarët e *Kuvendit* duhet të informohen së paku 14 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Do të thotë *Kuvendi* mund të thirret në afat prej së paku 30 ditëve.

Përgjegjësinë për dërgimin e ftesave e mban Sekretari.

Neni 7.5

Mbledhjet e *Kuvendit* caktohen:

- Me vendim të *Këshillit drejtues*
- Me propozim të një të tretës së anëtarëve të cilët kanë të drejtë vote. Propozimi dorëzohet deri te *Këshilli drejtues* dhe në atë qartë duhet të ceket shkaqet për *Kuvendin* e jashtëzakonshëm
- *Kuvendi* mban mbledhje dhe miraton vendime vetëm me kuorum të arritur, gjegjësisht nëse janë prezent 51% të anëtarëve të *Shoqatës*
- *Kuvendi* miraton vendime përmes votimit, gjatë së cilës vendimi miratohet nëse pranohet prej 51% të anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote.
- Mbledhja e Kuvendit, pa dallim nëse ka kuorum mund të anulohet nëse më shumë se gjysma e të pranishmëve votojnë për këtë.

Neni 7.6

Vendimet e *Kuvendit* do të jenë të vlefshme kur do të vërtetohet se:

- ftesa për *Kuvend* nuk ka arritur deri anëtar i caktuar për shkaqe për të cilat Shoqata nuk mund të përgjigjet.
- anëtarët të cilët nuk kanë qenë prezent në *Kuvend* do të marrin procesverbal nga vendimet e *Kuvendit*

Neni 8 Autorizimet e *Kuvendit*

Kuvendi është organ ligjdhënës dhe vepron në pajtim me të drejtat e parapara në këtë *Statut* në drejtim të realizimit të qëllimeve dhe detyrave të *Shoqatës*.

Kuvendi miraton vendime, pas rekomandimeve të sjella të *Këshillit drejtues*, për

- ndryshimi i qëllimit të *Shoqatës*
- ndryshimi i statutit
- plani dhe buxheti strategjik dhe operativ
- rregulloret dhe protokollet operative
- raport vjetor i *Shoqatës*, të cilin e publikon në www.hera.org.mk
- dorëzon raport financiar deri te organi kompetent i administratës shtetërore, gjegjësisht deri te organi i komunës, komnat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit në rastet kur shfrytëzohen mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht nga buxheti i njërive të vetëqeverisjes lokale
- raporte vjetore deri te donatorët
- angazhon revizorë të jashtëm
- ndryshimi i kriterit për anëtarësim dhe anëtarësi
- zgjedh dhe shkarkon anëtarë të *Shoqatës*
- emëron komisione
- vendos për ndërprerjen e *Shoqatës* sipas dispozitave të **Nenit 23**
- kryen edhe punë tjera në pajtim me statutin dhe aktet e *Shoqatës*

Neni 8.1

Kuvendi i shqyrton

- raportet e *Këshillit drejtues* dhe komisioneve tjera
- raportet e *Drejtorit ekzekutiv*

Neni 8.2

Kuvendi i zgjedh:

- anëtarët e *Këshillit drejtues*
- përfaqësuesit e Shoqatës në organizata tjera nacionale ose ndërkombëtare

Neni 8.3

- *Kuvendi* i cakton autorizimet, të drejtat dhe përgjegjësitë e *Këshillit drejtues*
- *Kuvendi* i cakton autorizimet dhe përgjegjësitë e punës të *Drejtorit ekzekutiv*
- *Kuvendi* i shqyrton dhe i harmonizon kushtet për punësim, rregullat financiare dhe procedurat tjera për punë të papenguar të *Shoqatës*

Neni 9 Autorizimet e Këshillit drejtues

Neni 9.1

Këshilli drejtues është organ i cili është i autorizuar nga Kuvendi që t'i zbatojë të gjitha të drejtat e Kuvendit, përveç:

- të miratojë vendime për të cilat vendos Kuvendi
- të emërojë anëtarë në *Këshillin drejtues* ose cilindo këshill tjetër të emëruar nga *Kuvendi*
- ta ndryshojë dhe ta plotësojë Statutin.

Neni 9.2

Me autorizim të *Kuvendit*, *Këshilli drejtues* emëron dhe e ndërron *Drejtorin ekzekutiv* të *Shoqatës Këshilli drejtues* e mbikëqyr dhe është përgjegjës për punën financiare dhe pronën e *Shoqatës Këshilli drejtues* përgatit politika të cilat i prezanton para *Kuvendit për miratim*.

Këshilli drejtues përgatit, miraton dhe rekomandon në *Kuvendin* vjetor që të shqyrtohen dhe të pranohen:

- propozon plan dhe buxhet strategjik dhe operativ
- propozon rregullore dhe protokolle operative
- dorëzon raport auditit vjetor të jashtëm
- dorëzon raporte vjetore deri te donatorët
- propozon amendamente për ndryshim të statutit
- propozon ndryshim të kriterëve për anëtarësim dhe anëtarësi
- propozon angazhimin e revizorëve të jashtëm
- propozon formimin e organeve punuese

Neni 9.3

Këshilli drejtues pranon, shqyrton dhe parashtron propozime deri te *Kuvendi*, të cilat janë dorëzuar nga ana e *Drejtorit ekzekutiv*, organet tjera punuese ose anëtarë të *Kuvendit*.

Neni 9.4

Këshilli drejtues i verifikon propozimet për anëtarë të ri ose propozimet për suspendim, e evidenton humbjen e të drejtës për anëtarësim dhe i dorëzon deri te *Kuvendi* për votim.

Gjatë kësaj udhëhiqet sipas kriterëve të vendosura në këtë Statut (Neni 5 dhe Neni 10).

Neni 9.5

Këshilli drejtues i ka këto obligime:

- e vëzhgon zbatimin e Statutit, Strategjisë dhe Programin e organizatës
- kujdeset për punën dhe pronën e organizatës
- bën vëzhgimin dhe shqyrtimin e zbatimit të mjeteve të miratuara vjetore dhe nëse është e mundur bën zëvendësimin e tyre
- e kontrollon mënyrën e punës së *Drejtorit ekzekutiv*
- i shqyrton dhe miraton raportet e *Drejtorit ekzekutiv* dhe i parashtron deri te Kuvendi për miratim
- e shqyrton llogarinë përfundimtare dhe raportin e auditit dhe i dorëzon për miratim deri te Kuvendi
- grumbullon dhe alocon mjete të reja
- dorëzon projekte të reja
- zhvillon politika të cilat i prezanton para *Kuvendit*
- raporton para Kuvendit për implementimin e vendimeve të miratuara
- suspendon dhe propozon përjashtim të anëtarëve në pajtim me Nenin 5.4.
- parashtron raporte vjetore për punën e vet para *Kuvendit*

Neni 9.6

Këshilli drejtues nga radhët e veta e zgjedh *Kryetarin* dhe *Sekretarin*, të cilët rregullisht raportojnë për punën e tyre.

Neni 9.7

Çdo anëtar i paguar me të drejtë vote ka të drejtë ta nominojë veten për anëtar të *Këshillit drejtues*.

Nominimet arrijnë në formë të shkruar deri te *Këshilli drejtues* më së voni deri 21 ditë para mbajtës së Kuvendit. *Këshilli drejtues* duhet ta vërtetojë pëlqimin e anëtarit të nominuar në formë të shkruar më së voni 15 ditë para Kuvendit.

Neni 9.8

Anëtarët e *Këshillit drejtues* zgjidhen në Kuvendin vjetor me shumicë (gjysma).

Anëtarët e *Këshillit drejtues* duhet të:

- marrin pjesë në mbledhjet e *Këshillit drejtues* dhe të *Kuvendit*

- marrin pjesë në realizimin e obligimeve dhe detyrave të *Këshillit drejtues*
 - e promovojnë Shoqatën
 - i përfaqësojnë qëllimet e Shoqatës
 - ndihmojnë në procesin e grumbullimit të mjeteve për realizimin e qëllimeve të Shoqatës
- Gjysma nga anëtarët e *Këshillit drejtues* do të jenë gra.
- Një anëtar i *Këshillit drejtues* do të jetë nën moshën 24 vjet.
- Drejtori ekzekutiv* në *Këshillin drejtues* dhe ex-officio nuk ka të drejtë vote.
- HERA i nxitë Personat të cilët jetojnë me HIV që të nominohet dhe të marrin pjesë aktive në *Këshillin drejtues*. Një pozitë e *Këshillit drejtues*, në pajtim me kriteret e shkruara për zgjedhje të anëtarëve, do të rezervohet për Person i cili jeton me HIV.

Neni 9.9

Anëtarët kanë mandat prej dy viteve, pas të cilit vazhdojnë të punojnë derisa *Kuvendi* nuk zgjedh anëtarë të ri të *Këshillit drejtues*, gjegjësisht derisa anëtari nuk zëvendësohet, jep dorëheqje ose vdes.

Anëtarët e *Këshillit drejtues* mund të mbeten së paku tre mandate të njëpasnjëshme. Pasi që anëtari do të punojë tre terminë të njëpasnjëshme ai/ajo mund të kandidohet përsëri pas një pauze prej 2 viteve.

Nuk do të lejohet që anëtari ta shmangë dhe ta shkurtojë mandatin duke shërbyer një vit më pak, që të mund të nominohet përsëri.

Pas shërbimit në këtë organ në gjatësi prej maksimum 12 vjet, anëtari tërhiqet dhe nuk ka të drejtë përsëri të nominohet për anëtar të *Këshillit drejtues*.

Neni 10

Anëtari i *Këshillit drejtues* dorëzon dorëheqje me shkrim e cila menjëherë hyn në fuqi, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe, gjatë kësaj dorëheqja është efektive dhe po mos pranohet nga *Këshilli drejtues*.

Anëtari mund të suspendohet me shumicë votash të anëtarëve të *Këshillit drejtues*.

Nëse lirohet ndonjë pozitë, mes dy Kuvendeve, vendi do të plotësohet me shumicë votash të anëtarëve të *Këshillit drejtues* të cilët kanë të drejtë vote. Gjatë kësaj kjo pozitë do të zgjatë vetëm deri në Kuvendin e ardhshëm.

Anëtari i *Këshillit drejtues* do të suspendohet nëse:

- fiton në pozitë në *Shoqatë (bile as si konsulent)*
- të jetë i gjykuar për shkak të falimentimit
- të bëhet jo stabil në vendimmarrje

- Në mënyrë indirekte dhe të drejtpërdrejtë është i interesuar për nënshkrimin e marrëveshjeve të caktuara me *Shoqatën*, mos e paraqesë atë interes dhe ai interes të realizohet në mënyra të paligjshme

- Të ketë qenë i gjykuar dhe i burgosur

- Mos paraqitet në dy mbledhje të njëpasnjëshme, pa e arsyetuar mungesën e tij.

Neni 10.1

Këshilli drejtues takohet së paku një herë në tre muaj.

Me mbledhjet kryeson kryetari ose personi të cilin e emëron ai. Nëse kryetari i shoqatës mungon a paralajmërim paraprak, vetë anëtarët e zgjedhin kryesuesin nga radhët e tyre.

Këshilli drejtues përbëhet prej 5 anëtarëve dhe sjell vendime me kuorum prej 3 anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote.

Në rast të numrave të njëjtë të votave Kryetari ka të drejtë për votë plotësuese që vendos.

Mbledhjet e *Këshillit drejtues* i cakton Kryetari më së voni deri 14 ditë para mbledhjes.

Neni 10.2

Shoqata mund të kryejë kompensim për çdo humbje që është paraqitur gjatë punës së anëtarëve të *Këshillit drejtues*.

Neni 11 Grupet punuese dhe komitetet tjera

Kuvendi themelon organe të veçanta varësisht nga nevojat të cilat paraqiten me aktivitetet aktuale. Përgjegjësinë e këtyre organeve e cakton Kuvendi dhe mënyra e punës së tyre është përcaktuar me rregullore të veçantë.

Neni 12 NËPUNËSIT E NDERIT

Nëpunësit e nderit në Shoqatë janë Kryetari dhe Sekretari.

Ata mund të zgjidhen nga radhët e anëtarëve me pagesë.

Zgjidhen nga radhët e *Këshillit drejtues*, me gjysmën e votave të anëtarëve të tij.

Neni 12.1

Nëpunësit e nderit kanë mandat prej dy viteve dhe mbeten në atë pozitë derisa nuk zgjidhen *nëpunës të ri të nderit* ose derisa nuk tërhiqen, shkarkohen ose vdesin. Nëpunësit e nderit mund të zgjidhen në tre mandate të njëpasnjëshme nga dy vjet. Mundësia e ardhshme për zgjedhje e anëtarët të njëjtë për pozitën e *nëpunësit të nderit* është pas pauzës prej një mandati, gjegjësisht 2 viteve. Numri i përgjithshëm i viteve në këtë pozitë është 12.

Neni 12.2

Nuk lejohet që një person njëkohësisht të kryejë dy funksione në Këshillin drejtues ose në ndonjë këshill të formuar nga Kuvendi.

Neni 12.3

Nëpunësi i nderit dorëzon dorëheqje me shkrim, e cila hyn menjëherë në fuqi, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe, gjatë kësaj dorëheqja është efektive edhe po mos pranohet nga *Këshilli drejtues*.

Nëpunësi i nderit mund të suspendohet me shumicë votash të anëtarëve të *Këshillit drejtues*.

Nëse lirohet pozita, mes dy Kuvendeve, vendin e *Nëpunësit të nderit* do të plotësohet nga personi i zgjedhur me shumicë votash të anëtarëve të *Këshillit drejtues*, të cilët kanë të drejtë vote. Gjatë kësaj kjo pozita do të zgjatë vetëm deri në Kuvendin e ardhshëm.

Neni 12.4

Autorizimet e nëpunësve tenderit janë caktuar nga shërbimi të cilin e kryejnë.

Ato janë definuar në këtë statut, edhe pse me rregullore të veçanta *Kuvendi* mund t'u japë autorizime të veçanta.

Neni 12.5

Kryetari është përfaqësues juridik i Shoqatës.

Ai kryeson me mbledhjet e *Këshillit drejtues* dhe me *Kuvendin*.

Kryetari kujdeset për rregullsinë e mbledhjeve të *Këshillit drejtues* dhe prezencën e anëtarëve të tij.

E nxitë dhe e vëzhgon punën e *Këshillit drejtues* dhe grupeve tjera punuese.

Kujdeset nëse të gjithë anëtarët e *Këshillit drejtues* i kanë të gjitha informatat e nevojshme për punën e *Shoqatës* (planet punuese, procesverbalet nga mbledhjet etj.).

E promovon *Shoqatën*, kryen promovimin e tij dhe ndihmon në gjetjen e mjeteve.

Bashkë me *Drejtorin ekzekutiv* dhe me *Sekretarin* përpilon program për mbledhjet punuese të *Këshillit drejtues*.

Kryen vlerësim vjetor të *Drejtorit ekzekutiv*.

Neni 12.6

Sekretari kujdeset dhe është përgjegjës për:

- azhurnimin e listës së anëtarëve të *Shoqatës* me (emër, mbiemër dhe adresë) dhe të gjitha listat tjera të cilat dot jenë të nevojshme

- dërgon dhe kujdeset që të arrijnë në kohë ftesat dhe lajmërimet për mbledhje

- përgatit program/rend dite për mbledhjet bashkë me *drejtorin ekzekutiv* dhe *kryetarin*
- mban evidencë për anëtarët e pranishëm të *Kuvendit* dhe të mbledhjeve të *Këshillit drejtues*
- përgatit shënime/procesverbale nga mbledhjet, të cilat u dërgohen anëtarëve dhe kryetarit për miratim, pas çka i arkivon.
- këshillon dhe kujdeset për respektimin e procedurave gjatë mbajtjes së mbledhjeve të *Këshillit drejtues* dhe *Kuvendit*
- kujdeset dhe siguron respektimin e këtij statuti, regjistrimin e *Shoqatës* dhe vendos lidhje me autoritetet tjera dhe siguron këshilla juridike për aktivitetet humanitare të *Shoqatës*
- kujdeset për komunikimin me anëtarët e *Shoqatës* mes dy kuvendeve
- i shtron për shqyrtim propozimet e anëtarëve para *Këshillit drejtues*
- bashkëpunim i vazhdueshëm me *Kryetarin* dhe *Drejtorin ekzekutiv*.

Neni 13 Drejtori ekzekutiv dhe të punësuarit

Për kryerjen e punëve administrative-profesionale, ndihmëse dhe punëve të ngjashme me interes të përbashkët për realizimin e detyrave dhe qëllimeve të *Shoqatës*, *Këshilli drejtues* zgjedh dhe i jep autorizime publike *Drejtorit ekzekutiv*.

Drejtori ekzekutiv për punën e tij përgjigjet para *Këshillit drejtues* dhe *Kuvendit*.

- *Drejtori ekzekutiv* është përfaqësues juridik i *Shoqatës*.
- *Drejtori ekzekutiv* do t'i udhëheqë aktivitetet e *Shoqatës* në pajtim me planin e miratuar të punës dhe planin e miratuar financiar, dhe vendimet tjera të *Kuvendit* vjetor
- *Drejtori ekzekutiv* është nënshkrues i llogarisë së *Shoqatës*;
- *Drejtori ekzekutiv* kujdeset për kryerjen në kohë të vendimeve dhe përfundimeve të miratuara nga *Kuvendi* dhe *Këshilli drejtues*;
- *Drejtori ekzekutiv* në qarkullimin pagesor ndërmarre masa edhe veprime në emër dhe për llogarinë e *Shoqatës*;
- *Drejtori ekzekutiv* kujdeset për aplikimin e drejt të rregulloreve ligjore nga fusha e veprimtarive që i kryen *Shoqata*.
- *Drejtori ekzekutiv* e ndjek dhe bën kontrollin e punës administrative financiare të shoqatës dhe për të njëjtën dorëzon raport tremujor deri te *Këshilli drejtues*.
- *Drejtori ekzekutiv* bën promovimin e aktiviteteve të organizatës
- *Drejtori ekzekutiv* propozon dhe përgatit projekte të reja
- *Drejtori ekzekutiv* bën implementimin e projekteve vijuese
- *Drejtori ekzekutiv* punëson dhe i lëshon nga puna personat të cilët i realizojnë projektet në rrjedhë
- *Drejtori ekzekutiv* gjen mjete plotësuese për projektet e reja

Neni 13.1

Asnjë person i punësuar nuk ka të drejtë të votojë në asnjë mbledhje ligjdhënëse të shoqatës, duke i përjashtuar mbledhjet e përditshme të punës.

Të punësuarit nuk guxojnë të fitojnë kurrfarë dobie materiale, as të drejtpërdrejta e as indirekte, duke e shfrytëzuar pozitën e vet në *Shoqatë*. Kjo ka të bëjë me do shitje, distribuim, promovim të materialeve ose shërbime.

I punësuarit nuk guxon të pranojë dhuratë ose honorar prej siguruesit aktual ose të ardhshëm të shërbimeve të *Shoqatës*.

Sipas nenit 5.7, vendosja e farefisit nga të punësuarit në pozita pune ose pozita konsulentë është e ndaluar.

Neni 14 Vlefshmëria e vendimeve

Asnjë vendim në cilindo takim të *Shoqatës* nuk do të shpallet si jo të vlefshme për shkak të papërshtatshmërisë të vërtetuar me vonë.

Neni 15 Procesverbalet nga mbledhjet

Do të bahet procesverbal nga të gjithë anëtarët të cilët do të jenë prezent në mbledhjet e *Shoqatës*, gjatë së cilës çdo anëtar do të nënshkruhet me emër dhe mbiemër të plotë dhe nënshkrimin e tij.

Procesverbalet do të përgatiten në të gjitha mbledhjet e anëtarëve, mbledhjet e *Këshillit drejtues* dhe grupet punuese.

Procesverbalet prezantohen në mbledhjen e ardhshme gjatë së cilës me mbështetje të anëtarëve të pranishëm do të pranohen dhe do të nënshkruhen nga kryesuesi.

Procesverbalet nga *Kuvendi* vjetor, i jashtëzakonshëm ose i anuluar do të nënshkruhen nga *Kryetari* dhe *Sekretari* dhe kopjet do të dorëzohen deri te të gjithë anëtarët. Procesverbali do të plotësohet edhe në zyrat e *Shoqatës* ku edhe do të dorëzohet deri te të gjithë anëtarët.

Procesverbalet origjinale nga takimet e *Këshillit drejtues* dhe grupet tjera punuese do të plotësohen në zyrat e *Shoqatës*.

Neni 16 Aspektet financiare

Për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të veta Shoqata në mënyrë të pavarur mund të:

- pranojë grante, dhurata, të shfrytëzojë beneficione, derisa janë në pajtim me Nenin 2
- të realizojë marrëveshje, të paguajë, të huazojë mjete në transaksione të miratuara nga *Shoqata*

- të kërkojë dhe të zbatojë aktivitete të ngjashme në përputhje me ligjin, me qëllim të grumbullojë fonde për funksionimin e vet
- të realizojë aktivitete bamirëse t cilat janë në pajtim me qëllimet dhe detyrat e parapara
- të punësojë persona me nevoja të veçanta për zbatimin e qëllimeve dhe detyrave
- t'i ndërmarre të gjitha veprimtaritë e parapara ligjore për realizimin e qëllimeve ehe detyrave të veta

Neni 17

Shoqata do të fitojë mjete dhe përmes:

- anëtarësisë
- mjete nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e komunave, komunat e Qytetit të Shkupit dhe buxheti i Qytetit të Shkupit
- mjete bamirëse
- donacione
- dhurata (të holla, të mira, të drejta prone), teste, legate.

Shoqata i realizon edhe veprimtaritë vijuese me të cilat sjell fitim, që përdoret vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë Statut:

- investime, interes, dividendë dhe huazime
- qiraja
- si dhe shërbime konsulence dhe shëndetësore, zbatimin e hulumtimeve, organizimin dhe zbatimin e trajnimeve
- dhe të ardhura tjera në pajtime Ligjin për shoqata dhe fondacione dh Statutit të Shoqatës

Neni 18

Shoqata qëllimet, detyrat dhe veprimtarë e veta do t'i realizojë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, këtë Statut, si dhe me normat tjera ligjore, të cilat e rregullojnë materien nga kjo fushë.

Raporti vjetor dhe financiar do të publikohet dhe do të jetë i kapshëm për opinionin përmes mediave elektronike të *Shoqatës* (www.hera.org.mk) më së voni deri më 30 pill për vitin paraprak.

Neni 19

Shoqata do të sigurojë se:

- puna financiare do të zhvillohet sipas ligjeve të parapara nacionale dhe ndërkombëtare për kontabilitet dhe punë financiare
- në nivel vjetor, do të realizohet audit i jashtëm dhe i pavarur financiar, i cili do të prezantohet para *Kuvendit*. Njëkohësisht, do të sigurohet mundësia që audit i jashtëm t'i drejtohet *Kuvendit*.
- zgjedhja e auditit të jashtëm do të zhvillohet sipas ligjeve ekzistuese dhe do të realizohet me tender publik.
- libri i kontabilitetit do të vendoset në zyrat ose në vend që do ta caktojë *Këshilli drejtues* dhe do të ketë qasje për anëtarët.
- Për shfrytëzimin dhe dispozicionin me mjete vendosin organet e *Shoqatës*, në pajtim me kompetencat e caktuara me këtë Statut, të cilët ndërmarrin masa për shfrytëzimin ekonomik të mjeteve dhe për pengimin dhe mënjanimin e paligjshmërisë.

Neni 20

Shoqata miraton plan vjetor financiar për të ardhurat dhe shpenzimet e *Shoqatës*.

Plani financiar i përmban të gjitha të ardhurat të cilat fitohen si dhe shpenzimet për aktivitetet e planifikuara, për shpenzimin e përbashkët të punësuarve, shpenzimet materiale për punën e *Shoqatës* dhe shpenzimet tjera lidhur me punën.

Neni 21

Në Kuvendin vjetor sipas nevojës miratohen edhe ndryshohen rregulloret për punë dhe rregulloret për rregullimin e hollësishëm të gjitha aktiviteteve të organeve të *Shoqatës*.

Neni 22

Ky statut dhe nenet e tij mund të pranohen ose të ndryshohen vetëm me shumicë të dy të tretave nga anëtarët që kanë të drejtë vote gjatë *Kuvendit* vjetor.

Nuk do të ketë votim nëse të gjithë anëtarët me të drejtë vote nuk informohen për ndryshimet e statutit së paku 14 ditë para mbajtjes së *Kuvendit*.

NDËRPRERJA E PUNËS SË SHOQATËS

Neni 23

Shoqata do të pushojë me punë nëse për këtë vendosin anëtarët e Shoqatës së qytetarëve, nëse numri i anëtarëve do të zvogëlohet nën numrin e caktuar për themelim, nëse ndodhin shkaqe të caktuara me nenin 63 të Ligjit për shoqata të qytetarëve dhe fondacionet.

Vendimin për ndërprerjen e punës së Shoqatës e miraton Kuvendi me shumicën e dy të tretave.

Të gjithë anëtarët duhet të informohen së paku 30 ditë para mbajtjes së Kuvendit me letër, me të cilën do të informohen për shkaqet e shpërbërjes.

Neni 24

- Shoqata në rast të shpërbërjes duhet t'i mbulojë të gjitha borxhet ose t'i kthejë mjetet e marra nga donatori nëse aktivitetet nuk janë plotësuar.

- Pas ndërprerjes së punës së Shoqatës, prona dhe të drejtat tjera dhe të ardhurat që mbeten pas përmbushjes së obligimeve, kalojnë në pronësi të shoqatës tjetër me aktivitet të njëjtë ose të ngjashëm.

- Kurrfarë mjete materiale të fituara gjatë punës së shoqatës nuk guxojnë të ndahen mes anëtarëve të shoqatës, të punësuarve ose nëpunësve të nderit.

Neni 25 DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Shoqata është person juridik. Shoqata e ka vulën, vulën katrore dhe simbolin e vet.

Vula është e rrumbull dhe e përmban emrin e Shoqatës: Shoqata e qytetarëve "H.E.R.A." Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim - Shkup.

Vula katrore e Shoqatës e përmban tekstin që vijon: Shoqata e qytetarëve "H.E.R.A." Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim - Shkup.

Numër _____

_____ / _____viti

Shkup.

Neni 26

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti kryhen me procedurë të njëjtë si dhe për miratimin e tij.

Neni 27

Ky Statut hyn në fuqi me ditën e miratimit.

Statuti i parë i Shoqatës së qytetarëve H.E.R.A. – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim është miratuar nga ana e Kuvendit më 20 shkurt 2000.

Ndryshimi i parë i Statutit të Shoqatës së qytetarëve H.E.R.A. – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim është miratuar më 21 shkurt 2006.

Kuvendi i Shoqatës së qytetarëve H.E.R.A. – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim më 31 maj 1999 e miratoi tekstin e pastruar të statutit.

Kuvendi i Shoqatës së qytetarëve H.E.R.A. – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim më 3 korrik 2010 e miratoi tekstin e pastruar të statutit.

K R Y E T A R

**i Këshillit drejtues të Shoqatës
së qytetarëve "H.E.R.A."
Asociacioni për edukim shëndetësor dhe
hulumtim**

Shkup, 31.05.2009

**Milena Stefanoviç
n.p.**